



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prapërditur më Datë: 29-11-2024			
Nr. i Organiut Org. Breg	Nomeri Breg	Shtetësi Sh. Breg	Vlera Vrednost
01-	035/02-	1354	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2 lidhur me pikën 6 të Ligjit për Dhënien e Pronës së Palujtshme të Komunës në Shfrytëzim Nr.06/L-092, neni 17, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënien në shfrytëzim dhe këmbim e pronës së palujtshme të komunës, nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d, neni 40, 41, shkronja a të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.11.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

**për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës**

### Neni 1

Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim të pronës së palujtshme të komunës, në shfrytëzim afatgjatë deri 20 vite (njëzet vite) për Njësia Kadastrale me Nr.P-70101018-00197, në zonën kadastrale në Devajë, me sipërfaqe prej 96342 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë, dhe Njësia Kadastrale me Nr.P-70101018-00200-0, në Zonën Kadastrale në Devajë, me sipërfaqe prej 130577 m<sup>2</sup>, e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Komisioni përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve si në vijim:

- Shefki Aliu, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
- Mustafë Islami, anëtar i komisionit, përfaqësues i ekzekutivit të komunës.
- Ali Bajrami, përfaqësues i kuvendit të komunës.
- Remzi Salihu, përfaqësues i kuvendit të komunës.
- Shyqeri Halabaku, përfaqësues i sektorit joqeveritar.

### Neni 2

Detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019).

Komisioni vlerësohet udhëheq me procedurat mbi dhënien e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim, si: shpallja e njoftimit publik për shprehjen e interesit për cakton çmimin fillestar, vlerëson ofertat dhe ja propozon kuvendit ofertën më të favorshme, si dhe informacione shtesë.

### Neni 3

Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së palujtshme të komunës, t'i zhvilloj procedurat e konkurimit të hapur dhe vlerësimin e ofertave.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset anëtarët e komisioni dhe Zyra e Prokurimit në Komunën e Vitisë.

### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarëve të komisionit;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI  
Bekim Azizi

